



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.191/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.191/2017 e datës 10.06.2017, nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 10.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni LDK-AKR, me të cilën pretendon se me datën 10.06.2017, aktivistët e koalicionit kanë vërejtur se rreth orës 03:00, të mesnatës kandidati për deputet Fisnik Ismajli, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje ka postuar në rrjetin social facebook, shkrime fushate duke shkelur heshtjen zgjedhore.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga subjekti politik, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1, pika b, e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, të gjitha llojet e marketingut zgjedhor pas orës 00:00, janë të ndaluara me ligj duke përfshirë edhe fushatat në media.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit LDK-AKR, e cila ka parashtruar ankesën nuk mundë të pohohet me

ndonjë provë shkelja eventuale e dispozitave ligjore si dhe ora dhe vendi i kryerjes se shkeljes se pretenduar, në rrjetin social facebook për shkeljen e heshtjes zgjedhore.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesa vlerësohet si e pabazuar duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.191/2017 më datën 10.06.2017.



Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.